

ЕЛИМИНАЦИЈА НА МАЧЕЊЕТО
И НЕЧОВЕЧКОТО ПОСТАПУВАЊЕ
ВО ЗАТВОРИТЕ И УСТАНОВИТЕ
ЗА ЛИШУВАЊЕ ОД СЛОБОДА

RAPORT PËR SITUATËN DHE KUSHTET NË STACIONET E POLICISË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT MARS – QERSHOR 2021

SHKUP, QERSHOR 2021

Наслов на оригиналот:

ИЗВЕШТАЈ ЗА СОСТОЈБАТА И УСЛОВИТЕ ВО ПОЛИЦИСКИТЕ СТАНИЦИ
ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, МАРТ- ЈУНИ 2021

Botues: Helsinki Committee for Human Rights
represented by Prof. Neda Zdraveva, PhD

Redaktore: Prof. Gordana Lazhetikj, PhD

Autorë: Ina Dzugumanova, Irena Zdravkova, Arben Gudachi

Përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe: Shenasi Jaji

Lektorimi: Elizabeta Poljoska

Dizajni grafik dhe shtypja: Masiva Dooel Shkup

Vendi i botimit: Shkup

Viti i botimit: 2021

Tirazhi i botimit: 100 ekzemplarë

CIP- Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

351.74.075.5(497.7)"2021"(047)

DZUGUMANOVA, Ina

Raport per situaten dhe kushtet ne stacionet e policise ne Maqedoni
per Periudhen : mars- qershor 2021 / [autorë Ina Dzugumanova, Irena
Zdravkova, Arben Gudachi ; përkthim nga gjuha maqedone në gjuhën shqipe
Shenasi Jaji].- Shkup : Helsinki committee for human rights, 2021.- 43
str. : ilustr. ; 21 см

Превод на делото: Извештај за состојбата и условите во полициските
станици во Република Северна Македонија : март- јуни 2021.- Фусноти
кон текстот

ISBN 978-608-4790-97-6

1. Zdravkova, Irena [автор] 2. Gudachi, Arben [автор]
а) Полициски станици-- Состојба и услови-- Македонија-- 2021--
Извештаи

COBISS.MK-ID 54903045



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian



Македонско здружение на млади правници



Ky botim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e ShMJR-së dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT E PËRDORURA	4
HYRJE	5
KORNIZA METODOLOGJIKE	7
KALENDARI I AKTIVITETEVE	8
REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	9
SP QENDËR (BEKO)	10
SP MANASTIR	13
SP VELES	18
SP KUMANOVË	22
SP TETOVË	25
SP SHTIP	28
SP KISELLA VODË	31
SP STRUMICË	34
SP OHËR	36
PASQYRË TABELARE E SITUATËS NË STACIONET E VIZITUARA TË POLICISË	42

SHKURTESAT E PËRDORURA

DhARM	–	Dhoma e Avokatisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KPT	–	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës
SP	–	Stacion i policisë
QPS	–	Qendra për Punë Sociale

HURJE

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit “Eliminimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor në burgjet dhe qendrat e paraburgimit”, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Për qëllimet e projektit, u nënshkrua një Memorandum bashkëpunimi midis Shoqatës Maqedonase të Avokatëve të Rinj, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Qëllimi i këtij projekti është t’i adresojë problemet sistemike në sigurimin e mbrojtjes së personave të privuar nga liria nga të gjitha format e torturave, trajtimit dhe dënimit çnjerëzor, për t’i identifikuar sfidat kryesore për krijimin e një mekanizmi efektiv për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria dhe për t’u dhënë përparesi masave të nevojshme për krijimin e një mekanizmi të tillë.

Raporti bazohet në vizitat në terren të realizuara nga përfaqësuesja e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut - Ina Xhugumanova, përfaqësuesve të Shoqatës Maqedonase të Avokatëve të Rinj - Irena Zdravkova dhe Arben Gudaçi si dhe nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Penale dhe Standardeve Profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme - Tatjana Kallajxhiska, Biljana Koceva dhe Cvetanka Cureva.

Nevoja për të kryer vizita në terren për ta vërtetuar situatën faktike në stacionet e policisë buron nga kritikrat e vazhdueshme që i adresojnë organizatat e shoqërisë civile, Avokati i Popullit dhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) në lidhje me kushtet materiale në stacionet e policisë, përdorimin e forcës së tepruar fizike ndaj personave të privuar nga liria dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore. Në fakt, KPT-ja në raportin¹ e tij të fundit për vizitën e pestë periodike në vendin tonë i cili u realizua në periudhën nga 2 deri më 12 dhjetor 2019 vëren se megjithëse ka progres në drejtim të kushteve materiale në stacionet e policisë për shkak të rindërtimit të shumicës së tyre, megjithatë disa prej kushteve janë ende

¹ <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-its-2019-visit-to-north-macedonia>

nën shkallën standarde, veçanërisht për shkak të mungesës së dritës dhe ngrohjes në dhomat e paraburgimit. Përveç të dhënave për kushtet materiale, KPT-ja në raportin e tij vëren një rritje të ngacmimeve fizike ndaj personave të privuar nga liria, si dhe shkelje të së drejtës për informimin e një pale të tretë gjatë privimit nga liria dhe të drejtën e qasjes në një avokat.

Gjatë realizimit të vizitave në terren, avokatët e angazhuar nga ShMJR-ja nuk kishin mundësi të flisnin me një person të paraburgosur sepse në shumicën e stacioneve të policisë nuk kanë takuar asnjë person të paraburgosur. Prandaj, përfaqësuesit nuk ishin në gjendje ta vërenin përdorimin e mundshëm të forcës së tepruar fizike ndaj një të paraburgosuri ose shkeljen e disa prej të drejtave në rast të privimit nga liria. Sidoqoftë, në mënyrë që të theksohet rëndësia e të drejtave procedurale për personat e privuar nga liria, ky raport do të përfshijë gjithashtu një përmbledhje të shkurtër të qasjes në një avokat si mekanizëm për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor.

Raporti përmban një përmbledhje të monitorimit të kryer në terren, duke u përqëndruar në progresin dhe sfidat kryesore të dokumentuara gjatë kohës së kryerjes së vizitave. Raporti gjithashtu përmban edhe rekomandime për secilin stacion të policisë, si dhe rekomandime të përgjithshme për institucionet kompetente me qëllim të përmirësimit të situatës dhe kushteve në stacionet e policisë.

KORNIZA METODOLOGJIKE

Qëllimi i raportit është të japë një përshkrim të hollësishëm të situatës dhe kushteve në stacionet e policisë në Maqedoni. Raporti bazohet në vizitat në terren në 9 stacione të policisë në nivelin e 8 sektorëve për punë të brendshme, si vijon: SP Qendër, SP Veles, SP Kumanovë, SP Tetovë, SP Shtip, SP Kisella Vodë, SP Strumicë dhe SP Ohër. Qëllimi i vizitave në terren është dokumentimi i kushteve materiale në stacionet e policisë në mjediset e paraburgimit, dhomat e bisedave informative me personat e privuar nga liria, ambientet administrative, tualetet, etj., në mënyrë që të mbrohen personat e privuar nga liria nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në stacionin e policisë.

Vizitat janë realizuar në periudhën mars - qershor 2021, pas një plani të vizitës të aprovuar më parë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqatës Maqedonase të Avokatëve të Rinj gjatë vizitave u drejtuan nga standardet e vendosura ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria: Standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), Ligji për Policinë, Ligji për Punët e Brendshme dhe aktet nënligjore në fuqi të kësaj fushe.

Vizitat në terren në stacionet e policisë kryhen në bazë të një metodologjie të paracaktuar që përqendrohet në: kushtet materiale në dhomat e paraburgimit dhe dhomat për biseda, disponueshmëria e mjeteve materiale dhe teknike, numri i personave të punësuar, bashkëpunimi i stacionit të policisë me institucionet e tjera (QPS, ISHP, etj.), rastet e përdorimit të forcës së tepruar fizike, numri i personave të privuar nga liria dhe i personave të paraburgosur, numri i personave të paraburgosur që kanë kërkuar avokat dhe ndihmë mjekësore, etj.

Ekipi i monitorimit është i përbërë nga juristë, kurse në disa prej vizitave në ekip u përfshinë edhe avokatë të angazhuar nga ShMJR-së, në mënyrë që të bisedojnë mundësisht me një të paraburgosur dhe të ofrojnë ndihmë të

drejtpërdrejtë juridike në rast të torturave dhe trajtimit çnjerëzor gjatë gjithë kohës së paraburgimit.

Gjatë realizimit të vizitave, janë përdorur pajisjet për matjen e lagështisë, dritës dhe temperaturës me qëllim të përcaktimit të duhur të situatës faktike në ambientet e paraburgimit të personave.

Për gjetjet nga të gjitha vizitat janë përgatitur raporte të brendshme, të cilat dorëzohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të cilët kanë mundësi t'i paraqesin komentet dhe vërejtjet e tyre mbi pretendimet dhe rekomandimet për secilën vizitë individuale. Vizita pasuese nga ekipi i monitorimit janë planifikuar në të paktën tre stacione të policisë ku janë vërejtur numri më i madh i mangësive dhe lëshimeve.

KALENDARI I AKTIVITETEVE

SP Qendër	–	18.03.2021
SP Manastir	–	01.04.2021
SP Veles	–	09.04.2021
SP Kumanovë	–	16.04.2021
SP Tetovë	–	23.04.2021
SP Shtip	–	20.05.2021
SP Kisella Vodë	–	27.05.2021
SP Strumicë	–	02.06.2021
SP Ohër	–	11.06.2021

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME STATUSI I PERSONELIT

- Shtim personeli në përputhje me aktet për sistematizim;
- Përmirësimi i përfaqësimit gjinor.

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE MATERIALE

- Rindërtimi i ambienteve të paraburgimit dhe ambienteve për biseda me të paraburgosurit me qëllim të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria;
- Ndërtimi i objekteve të reja për stacionet e policisë të vendosura në ndërtesat e vjetra që nuk i plotësojnë standardet;
- Sigurimi i një numri të mjaftueshëm të automjeteve zyrtare në të gjitha stacionet e policisë;
- Përshtatja e dhomave të veçanta për të biseduar me fëmijët në përputhje me Ligjin për Drejtësinë e Fëmijëve;
- Vendosja e mbikëqyrjes funksionale me video dhe audio në dhomat e paraburgimit dhe dhomat për bisedë me të paraburgosurit. Nevoja për një sistem të tillë funksionues do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në hetimet për rastet e forcës së tepruar fizike si dhe në rastet e (vetë)lëndimit të të paraburgosurve;
- Theksimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në një vend të arritshëm për personat në mënyrë që t'i njohin ata dhe më shpesh të përdorin disa të drejta të caktuara ligjërish;
- Vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe DhARMV-së në mënyrë që të ketë qasje të papenguar në të drejtën e avokatit për të gjithë personat e privuar nga liria;
- Sigurimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuara fizike në dhomat e paraburgimit dhe dhomat për biseda.

SP QENDËR (BEKO)

Më 18 mars 2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Qendër.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në SP Qendër u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandantin dhe udhëheqësin e turnit të stacionit të policisë.

Gjatë bisedës me komandantin dhe udhëheqësin e turnit, ne morëm informacion se numri i përgjithshëm i të punësuarve në stacionin e policisë është vetëm 50% e numrit të përgjithshëm të personave që duhet të punësohen sipas statusit të përshkruar të personelit me aktin e sistematizimit. Sa i përket përfaqësimit gjinor, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 20 nga të punësuarit janë gra të cilat kryejnë kompetenca të policisë në terren.

Punonjësit e stacionit të policisë informuan se për shkak të frekuencës së lartë të stacionit, ata shpesh kanë persona të paraburgosur si autorë të kundërvajtjeve dhe veprave të ndryshme penale. Kështu, në periudhën nga 15.02.2021 deri më 15.03.2021 në SP Qendër u privuan nga liria 31 persona të moshës nga 16-57 vjeç. Nga këta, 13 persona ose 42% e të privuarve nga liria u mbajtën në paraburgim për një periudhë prej 1 orë e 45 minuta deri në 21 orë. 2 persona u trajtuan me masa detyrimi dhe vetëm 9 persona ose 29% e ushtruan të drejtën e tyre për një avokat. Asnjë person nuk e ka ushtruar të drejtën për ndihmë mjekësore dhe asnjë person nuk është ankuar për sjellje neglizhente, joprofesionale dhe të paligjshme të punonjësve të policisë.

Si një problem i rëndësishëm, komandanti e vuri në dukje qasjen në ndihmë juridike, respektivisht të drejtën për një avokat që u përket personave të paraburgosur. Gjegjësisht, shpesh avokatët sipas detyrës zyrtare nuk u përgjigjen thirrjeve të bëra nga personat e paraburgosur dhe gjithashtu u theksua se SP Qendër nuk ka një listë të azhurnuar të avokatëve të detyrës të cilët mund të thirren, për të cilët ata iu drejtuan DhARMV-së.

Për më tepër, ne u informuam se të paraburgosurit shpesh refuzonin të kërkonin ndihmë mjekësore. Për personat që janë në paraburgim për më shumë se 6 orë në një stacion të policisë komandanti informoi se janë siguruar fonde nga buxheti për të siguruar një shujtë të duhur ushqimore.

Kushtet materiale

SP Qendër ka vetëm 2 zyra administrative dhe vetëm 1 dhomë bisedash dhe 1 dhomë paraburgimi.

Veçanërisht është shqetësuese që personat me aftësi të kufizuara fizike nuk kanë qasje adekuate në dhomat e bisedës dhe paraburgimit.

Dhoma e bisedës u gjet në gjendje të pastër dhe solide. Në dhomë ka tavolina dhe karrige të salduara për shkak të të cilave nuk ka mundësi që personi i paraburgosur të (vetë)lëndohet.

Një sistem audio-video është instaluar në dhomën e paraburgimit dhe i njëjti është në funksion.

Dhoma e paraburgimit i plotëson kërkesat e standardeve të KPT-së për sa i përket gjatësisë, gjerësisë, lartësisë, lagështisë, dritës së ditës dhe dritës artificiale. Dhoma ishte e pastër. Kishte një shtrat në dhomë me jastëk, batanije dhe shtroje të pastër, për të cilët udhëheqësi i turnit na informoi se vetë punonjësit i pastrojnë në shtëpitë e tyre. Dhoma kishte ngrohje në dysheme dhe u vu re se ishte regjistruar një sistem funksional thirrjeje (zile) në rast të ndonjë nevojë të personit të paraburgosur.

Në stacionin e policisë nuk ka dhomë për të biseduar me fëmijët, megjithëse ndonjëherë fëmijët thirren për një bisedë informative. Komandanti i stacionit të policisë na informoi se në raste të tilla biseda zhvillohet në një dhomë të veçantë dhe jo në atë të paraparë për bisedë. Ne nuk patëm mundësi ta shohim atë dhomë të veçantë.

Tualeti për të paraburgosurit gjithashtu u gjet në nivel të kënaqshëm të higjienës. Tualeti kishte një wc, lavaman dhe dush që më pas u zbulua se nuk përdorej. Nuk kishte sende në tualet të tilla si pasqyra, sende të thyera, xham dhe të ngjashme, që mund të përdoren për (vetë)lëndime.


Për shkak të mungesës së hapësirave për biseda dhe marrje në pyetje, punonjësit përballesh me probleme serioze dhe çorganizim. Ata theksuan se një rrjedhë e tillë e punës u krijon një problem të madh në punën e tyre të përditshme sepse nuk kanë ku t'i pranojnë palët/të paraburgosurit nëse janë më shumë se 2 persona. Kjo veçanërisht ndikon në besimin e qytetarëve në vendimin për të raportuar një ngjarje në stacionin e policisë sepse ata janë të detyruar të presin disa orë në stacionin e policisë. Përveç mungesës së ambienteve dhe zyrave administrative, stacioni i policisë gjithashtu përballesh me një mungesë të automjeteve zyrtare. Kështu, stacioni ka vetëm 2 automjete ndërhyrjeje, të cilat nuk janë në gjendje të rregullt dhe shpesh servisohen dhe gjithashtu përballesh edhe me mungesë të motoçikletave.

Për shkak të vendndodhjes, SP Qendër është një stacion mjaft i ngarkuar, por mungesa e kushteve materiale dhe teknike bën që të paraburgosurit të transferohen shpesh në stacionin më të afërt të policisë si SP Bit Pazar dhe SP Kisella Vodë.

Gjatë kohës së zhvillimit të vizitës nuk takuam asnjë person të paraburgosur.



Dhoma për biseda



Dhoma për personat e paraburgosur

Rekomandime:

- Sigurimi i më shumë hapësirave për biseda dhe paraburgim të personave të privuar nga liria;
- Sigurimi i automjeteve funksionale të shërbimit për ndërhyrje;
- Sigurimi i një hapësire/dhome për biseda me fëmijë;
- Punësimi i një numri të mjaftueshëm të oficerëve të policisë në përputhje me aktin për sistematizim.

SP MANASTIR

Më 02.04.2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Manastir.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në SP Manastir u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandantin dhe udhëheqësin e turnit të stacionit të policisë.

Gjatë bisedës me komandantin dhe udhëheqësin e turnit, ne morëm informacion se numri i përgjithshëm i të punësuarve në stacionin e policisë është 79 persona dhe numri i personave që duhet të punësohen sipas aktit të sistematizimit është 130, pra 39% e vendeve të planifikuara të punës janë të paplotësuara. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 10 janë gra.

Në periudhën nga 01.03.2021 deri më 01.04.2021 në SP Manastir u privuan nga liria 21 persona të moshës 22-68 vjeç. 4 prej tyre u mbajtën në paraburgim për 5 deri në 9 orë. Një mjet detyrimi u zbatua ndaj 4 personave. Asnjë person nuk e ushtroi të drejtën e tij për avokat. Dy persona e ushtruan të drejtën e tyre për ndihmë mjekësore dhe askush nuk paraqiti ankesë për shkak të trajtimit neglizhent, joprofesional dhe të paligjshëm të oficerëve të policisë.

Si një problem i rëndësishëm, komandanti e vuri në dukje qasjen në ndihmë juridike, respektivisht të drejtën për një avokat që u takon të arrestuarve. Gjegjesisht, avokatët mbrojtës sipas detyrës zyrtare shpesh nuk u përgjigjen thirrjeve të personave të paraburgosur.

Për personat që janë në paraburgim për më shumë se 6 orë në një stacion policior, komandanti informoi se ata nuk kanë mundësi financiare për t'u siguruar atyre një shujtë, respektivisht të arrestuarit ushqimet e tyre i blejnë me fondet e tyre.

Kushtet materiale

SP Manastir ka 12 zyra administrative dhe 3 dhoma për paraburgim. Personat me aftësi të kufizuara fizike kanë qasje në stacionin e policisë, por nuk kanë qasje në dhomat e paraburgimit, pasi ato ndodhen në bodrumin e stacionit të policisë ku nuk sigurohet qasja për personat me aftësi të kufizuara fizike.

Dhomat e paraburgimit i plotësojnë kërkesat e standardeve të KPT-së për sa i përket gjatësisë, gjerësisë, lartësisë, lagështisë, dritës së ditës dhe dritës artificiale. Ekipi i monitorimit vuri re se nuk kishte ngrohje në mjediset e paraburgimit, gjë që në kushtet e dimrit kontribuoi që të paraburgosurit të qëndronin në temperatura të ulëta. Dhomat u gjetën në kushte mjaft të mira higjienike. Ato ishin të pajisura me 2 shtretër secila dhe në dy nga tre dhomat kishte 2 tavolina dhe 2 karrige që ishin të fiksuara mirë në dysheme, në mënyrë që të mos u shërbenin të paraburgosurve për (vetë)lëndim. Shtretërit në dhomat ishin të pajisura me një dyshek, jastëk dhe batanije që ishin gjetur të ndyra. Është vërejtur se në dhomat ekziston një sistem funksional për thirrje (zile) në rast të ndonjë nevojë të personit të paraburgosur, por as në dhomat e paraburgimit dhe as në dhomat e tjera, mbikëqyrja funksionale me video nuk ishte aktivizuar.

Afishet me të drejtat e personave të privuar nga liria ishin shfaqur në një vend të dukshëm në hyrje të stacionit të policisë, si dhe në pjesën e dhomave të paraburgimit.

Tualeti për të arrestuarit u gjet në një gjendje dukshëm të ndyrë. Ai ishte i pajisur me një vrimë dhe një lavaman dhe nuk kishte sende në tualet të tilla si pasqyra, sende të thyera, xham dhe të ngjashme, që mund të përdoren për (vetë)lëndim.

Vërejtje e ekipit të monitorimit është se ka vetëm një tualet për të 3 dhomat e paraburgimit. Standardet e KPT-së kërkojnë që stacioni i policisë të ketë një tualet për secilën dhomë paraburgimi dhe nëse kjo nuk është e mundur, të paraburgosurit duhet të kenë qasje të papenguar në tualet pa

pasur nevojë t'u telefonojnë zyrtarëve, gjë që nuk është rasti në SP Manastir ku ka vetëm 1 tualet dhe në rast nevojë për përdorim, personat e paraburgosur duhet t'i thërrasin personat zyrtarë. Për më tepër, në tualet nuk kishte asnjë derë, e cila në këtë mënyrë e shkel privatësinë e personave të privuar nga liria.


Stacioni i policisë ka gjithashtu një dhomë për të biseduar me fëmijët. Komandanti i stacionit të policisë na informoi se shumë shpesh në raste të privimit të lirisë ose thirrjes për një bisedë informuese me një fëmijë, stacioni i policisë ka problem në bashkëpunimin me QPS-në. Gjegjesisht, zyrtarët na njoftuan se ndodh që QPS-ja nuk merr masa për kujdesin ndaj fëmijëve, kështu që fëmija duhet ta kalojë natën në stacionin e policisë.

Stacioni i policisë gjithashtu përballet me një mungesë të automjeteve zyrtare, respektivisht SP Manastir ka 3 automjete për ndërhyrje, nga të cilat vetëm një është funksional dhe 2 automjetet e tjera shpesh servisohen. Në të njëjtën kohë, stacioni i policisë nuk ka një automjet "civil", për shkak të të cilit në rast nevojë që një fëmijë të privohet nga liria dhe të dërgohet në një stacion të policisë, zyrtarët detyrohen ta shoqërojnë fëmijën me një automjet të policisë, gjë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe legjislacionin e vendit tonë.


Ndër të tjera, zyrtarët nga SP Manastir theksuan se ata nuk kanë uniforma të mjaftueshme për të gjithë zyrtarët dhe nuk kanë kompjuterë në secilën zyrë dhe si një vështirësi në punën e tyre të përditshme ata e theksuan mbingarkimin me dokumentacionin administrativ që u merr shumë kohë.

Gjatë kohës së zhvillimit të vizitës nuk takuam asnjë person të paraburgosur.

Ambiente/dhoma për personat e paraburgosur



Ambiente/dhoma për personat e paraburgosur



Rekomandime:

- Sigurimi i automjeteve funksionale të shërbimit për ndërhyrje;
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet SP Manastir dhe IP QPS Ndër-Komunale Manastir në rastet e paraburgimit të të miturve;
- Punësimi i një numri të mjaftueshëm të oficerëve të policisë për ta përmbushur kuotën e parashikuar në përputhje me aktin për sistematizim;
- Sigurimi i kushteve materiale dhe teknike në stacionin e policisë për sa u përket uniformave zyrtare dhe kompjuterëve për punonjësit e policisë;
- Përmirësimi i kushteve të tualetit në dhomat e paraburgimit;
- Sigurimi i ngrohjes në dhomat për personat e paraburgosur;
- Sigurimi i fondeve nga buxheti për prokurimin e shujtave për personat e paraburgosur në një stacion të policisë për më shumë se 6 orë.

SP VELES

Më 09.04.2021, ekipi i monitorimit realizoi një vizitë të rregullt në SP Veles.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në SP Veles u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandantin dhe udhëheqësin e turnit të stacionit të policisë.

Gjatë bisedës me komandantin dhe udhëheqësin e turnit, ne morëm informacion se numri i përgjithshëm i të punësuarve në stacionin e policisë është 85 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 11 janë gra.

Në periudhën nga 08.03.2021 deri më 08.04.2021 në SP Veles u privuan nga liria 41 persona të moshës 22-58 vjeç. Nga këta, 18 persona u mbajtën në paraburgim për 8 deri në 14 orë. Vetëm në 1 rast është përdorur mjet detyrimi dhe 5 persona e kanë ushtruar të drejtën e tyre për avokat. E drejta për ndihmë mjekësore u ushtrua nga 1 person dhe asnjë person nuk paraqiti ankesë për shkak të sjelljes neglizhente, joprofesionale dhe të paligjshme të punonjësve të policisë.

Komandanti theksoi se SP-ja ka bashkëpunim të mirë me avokatët të cilët janë në listën e avokatëve sipas detyrës zyrtare, por më shpesh personat e paraburgosur i kontaktojnë avokatët e tyre.

Për personat që janë paraburgosur për më shumë se 6 orë në një stacion të policisë, komandanti informoi se ata nuk kanë mundësi financiare për t'u siguruar atyre një shujtë, respektivisht të arrestuarit i blejnë vetë ushqimet e tyre.

Kushtet materiale

SP Veles ka rreth 10 zyra administrative dhe 4 dhoma për paraburgim të personave. Personat me aftësi të kufizuara fizike kanë qasje në stacionin e

policisë, por nuk kanë qasje në dhomat e paraburgimit sepse ato janë të vendosura në bodrumin e stacionit të policisë ku nuk sigurohet qasja për personat me aftësi të kufizuara fizike.

Afishet me të drejtat e personave të privuar nga liria ishin shfaqur në hyrje të stacionit të policisë.

Dhomat e paraburgimit nuk i përmbushin kërkesat e standardeve të KPT-së për sa i përket gjatësisë, gjerësisë, lartësisë, lagështisë, dritës së ditës dhe dritës artificiale, kryesisht sepse ato ndodhen në bodrume ku lagështia është e lartë dhe nuk ka dritë të ditës. Ekipi i monitorimit gjithashtu vuri në dukje se nuk ka ngrohje në ambientet e paraburgimit, gjë që në kushtet e dimrit kontribuon që të paraburgosurit të qëndrojnë në temperatura të ulëta. Dhomat u gjetën në kushte të këqija higjienike. Ato ishin të pajisura me nga 2 shtretër secila. Shtretërit në dhomat ishin të pajisura me nga një dyshek, jastëk dhe bataniqe që ishin gjetur të pastër dhe për larjen e tyre stacioni i policisë bashkëpunon me Ushtrinë dhe Institucionin e Shëndetit Publik sepse stacioni nuk ka lavanderi. Është vërejtur që dhomat kishin mbikëqyrje funksionale me video, por nuk ishte regjistruar asnjë sistem thirrjeje (zile) në dhomat e paraburgimit.

Tualeti në dhomat e paraburgimit u konstatua se kishte nivel shumë të ulët të higjienës dhe sende që mund të përdreshin për (vetë)lëndime. Në tualet nuk kishte ujë dhe sapun, kurse njëra kabinë nuk ishte aspak funksionale.

Stacioni i policisë nuk ka dhoma për të biseduar me të paraburgosurit dhe për këtë qëllim oficerët e policisë i përdorin zyrat e tyre.

Nga ana tjetër, stacioni i policisë ka një dhomë për të biseduar me fëmijët. Komandanti i Stacionit të Policisë na informoi se ata kanë bashkëpunim të mirë me QPS-të në rastet e privimit të lirisë së fëmijëve.

SP Veles gjithashtu përballet me një mungesë të automjeteve zyrtare sepse ka 1 automjet ndërhyrjeje që shpesh servisohet dhe për këtë arsye SP-ja ka

nevojë për automjete zyrtare funksionale. Për punë në terren, stacioni ka nevojë për 2 deri në 3 automjete.

Gjatë kohës së zhvillimit të vizitës nuk takuam asnjë person të paraburgosur.



Ambiente/dhoma për personat e paraburgosur





Tualeti për personat e paraburgosur

Rekomandime:

- Rindërtimi i plotë i dhomave të paraburgimit në përputhje me standardet e KPT-së;
- Rindërtimi i plotë i tualetit në dhomat e paraburgimit;
- Sigurimi i automjeteve funksionale zyrtare të ndërhyrjes dhe automjeteve të terrenit;
- Sigurimi i fondeve nga buxheti për prokurimin e shujtave për personat e paraburgosur në një stacion të policisë për më shumë se 6 orë.

SP KUMANOVË

Më 16.04.2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Kumanovë.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në stacionin e policisë u krye në atë mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandanten dhe shefin e stacionit të policisë.

Gjatë bisedës me komandanten dhe shefin e stacionit të policisë, morëm informacion se numri i përgjithshëm i punonjësve në stacionin e policisë është 141 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 21 janë gra.

Ndërtesa e stacionit të policisë është ndërtuar në vitin 1929 dhe në kohën e vizitës monitoruese po zhvillohej rindërtimi i saj, respektivisht rindërtimi i dhomave për paraburgimin e personave dhe marrjen në pyetje të personave. Rindërtimi kishte filluar në janar dhe pritet të përfundojë në gusht të vitit 2021.

Në periudhën prej 15.03.2021 deri më 15.04.2021 në Stacionin e Policisë Kumanovë, 31 persona të moshës 21-61 vjeç ishin privuar nga liria. Të gjithë u mbajtën në paraburgim për një periudhë prej 35 minutash deri në 23 orë e 15 minuta. Vetëm në 1 rast është aplikuar një mjet detyrimi dhe asnjë person nuk e ka ushtruar të drejtën e avokatit, as të drejtën e ndihmës mjekësore. Askush nuk ishte ankuar për sjelljen neglizhente, joprofesionale dhe të paligjshme të oficerëve të policisë.

Komandantja theksoi se stacioni i policisë ka bashkëpunim të mirë me avokatët që janë në listën e avokatëve sipas detyrës zyrtare.

Për personat që janë paraburgosur për më shumë se 6 orë në stacionin e policisë, komandantja informoi se ata kanë mundësi financiare për t'u siguruar atyre një shujtë ushqimi.

Kushtet materiale

SP Kumanovë aktualisht ka vetëm 1 dhomë për bisedë në të cilën mbahen edhe personat e paraburgosur. Dhoma është e pajisur me tavolina dhe karrige, por nuk ka shtretër në rast të paraburgimit të zgjatur të personave të privuar nga liria. Gjatë kohëzgjatjes së paraburgimit të tyre, personat janë nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe prani fizike nga oficerët e policisë. Personat me aftësi të kufizuara fizike kanë qasje në stacionin e policisë.

Afishet me të drejtat e personave të privuar nga liria ishin shfaqur në hyrje të Stacionit të Policisë.

Dhomat e paraburgimit që ishin në fazën e rindërtimit janë gjithsej 5 me nga 2 shtretër secila. Në të njëjtën kohë, rindërtohen edhe një dhomë për marrje në pyetje, një për identifikim dhe një dhomë për marrje në pyetje të fëmijëve dhe viktimave të dhunës në familje.

SP-ja gjithashtu përballlet me një mungesë të automjeteve zyrtare, pasi ka 2 automjete ndërhyrjeje dhe 1 automjet shoqëruar. Ata i kanë dërguar një kërkesë Byrosë së Sigurisë Publike për prokurimin e 2 automjeteve të terrenit dhe 4 automjeteve të tjera.

Për më tepër, SP-ja nuk ka mbikëqyrje funksionale me video në dhomat e marrjes në pyetje dhe paraburgimit, as në dhomat e paraburgimit dhe marrjes në pyetje që po rindërtohen.

Në mënyrë domethënëse, SP-ja e theksoi punën parandaluese që ata e kryejnë brenda kompetencave të tyre. Departamenti i Parandalimit në Stacionin e Policisë Kumanovë rregullisht zhvillon biseda këshilluese me banorët e bashkësive lokale, të cilat zhvillohen me prani fizike, por në kohë pandemie ato janë kryesisht përmes telefonit. Departamenti me 4 punonjës kryen gjithashtu aktivitete parandaluese me të rinjtë, veçanërisht në shkolla dhe me grupet e tifozëve.

Gjatë kohës së kryerjes së vizitës, u takua një person i privuar nga liria, i cili nuk u mbajt në paraburgim.

Rekomandime:

- Sigurimi i automjeteve funksionale zyrtare të ndërhyrjes dhe automjeteve të terrenit;
- Sigurimi i mbikëqyrjes funksionale me video në dhomat e paraburgimit dhe marrjes në pyetje të personave;
- Gjatë rindërtimit të ambienteve të paraburgimit, personat e privuar nga liria nuk duhet të mbahen më shumë se 3 orë në dhomën e marrjes në pyetje, as nuk duhet të lejohen ta kalojnë natën në atë dhomë.

SP TETOVË

Më 23 prill 2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Tetovë.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në stacionin e policisë u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me zëvendës shefin, komandantin, zëvendës komandantin, ndihmës komandantin dhe udhëheqësin e turnit në SP Tetovë.

Gjatë bisedës me punonjësit morëm informacion se numri i përgjithshëm i punonjësve në stacionin e policisë është 109 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 7 janë gra.

Në periudhën nga 22 mars 2021 deri më 22 prill 2021, 88 persona të moshës 18-72 vjeç u privuan nga liria në SP Tetovë. Prej tyre, 65 u mbajtën në paraburgim nga 1 orë deri në 18 orë. Në 6 raste është përdorur një mjet i detyrimit dhe vetëm 4 persona e kanë ushtruar të drejtën e tyre për avokat. Asnjë person nuk e ushtroi të drejtën e tij për ndihmë mjekësore.

SP-ja ka bashkëpunim të mirë me QPS-të kompetente - Tetovë në rast të një fëmije të privuar nga liria, si dhe me Institucionin e Shëndetit Publik në rast nevojë për ndihmë mjekësore për një person të privuar nga liria. Në anën tjetër, punonjësit na informuan se ata kanë bashkëpunim të dobët me QPS-të - Gostivar dhe gjithashtu me Prokurorinë Themelore Publike - Tetovë, e cila shpesh u jep udhëzime që personat e privuar nga liria të mbahen në paraburgim dhe menjëherë më vonë e ndryshon urdhëresën ose urdhëron që personat të lirohen duke rezultuar në një numër të madh të të paraburgosurve pa ndonjë arsye. Punonjësit e Stacionit e Policisë Tetovë na informuan se personat e paraburgosur rrallë kërkojnë avokat dhe nëse kanë ndonjë nevojë të tillë, ata zakonisht i kontaktojnë avokatët e tyre privatë.


Për ata të paraburgosur për më shumë se 6 orë në një stacion të policisë, stacioni ka burime financiare për të siguruar ushqim për të paraburgosurit.

Kushtet materiale

SP Tetovë ka 3 dhoma për paraburgim dhe 2 dhoma për bisedë.

Dhomat për paraburgimin e personave kanë 2 shtretër, një tavolinë dhe një karrige që janë të fiksuara në dysheme dhe i plotësojnë standardet për madhësinë, gjerësinë dhe gjatësinë, dritën, temperaturën dhe lagështinë. Për më tepër, afishet me të drejtat e të paraburgosurve ishin bashkangjitur në ambientet. Ambientet e paraburgimit kishin gjithashtu një tualet për të paraburgosurit që plotësisht i plotësonte standardet dhe kishte një nivel të kënaqshëm të higjienës. Ekziston një sistem funksional i mbikëqyrjes me video dhe sistem për thirrje në dhomat e paraburgimit.


Stacioni i policisë po përballet me një mungesë të automjeteve zyrtare, përkatësisht ka vetëm 1 automjet ndërhyrjeje, por gjithashtu po përballet me një mungesë të ambienteve ose zyrave administrative.



Tualeti për personat e paraburgosur



Dhoma për biseda



Dhoma e paraburgimit

Rekomandime:

- Sigurimi i automjeteve funksionale të shërbimit për ndërhyrje;
- Sigurimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuara fizike.

SP SHTIP

Më 20.05.2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Shtip.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandantin dhe udhëheqësin e turnit në SP Shtip.

Gjatë bisedës me punonjësit, morëm informacionin se numri i përgjithshëm i punonjësve në stacionin e policisë është 69 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 7 janë gra.

Në periudhën nga 20.04.2021 deri më 20.05.2021 në SP Shtip u privuan nga liria 14 persona të moshës 15-65 vjeç. 8 prej tyre u mbajtën në paraburgim dhe kundër 4 u përdorën mjete detyrimi - pranga. Vetëm 1 person kërkoi avokat dhe askush nuk kërkoi ndihmë mjekësore. Kohëzgjatja e paraburgimit ishte nga 50 minuta deri në 11 orë e 30 minuta.

Stacioni i policisë ka bashkëpunim të mirë me QPS-në kompetente në rast të një fëmije të privuar nga liria, si dhe me Institucionin e Shëndetit Publik në rast nevojë për ndihmë mjekësore për një person të privuar nga liria.

Për personat e paraburgosur për më shumë se 6 orë në një stacion të policisë, stacioni ka burime financiare për t'u siguruar atyre një shujtë ushqimi.

Kushtet materiale


SP Shtip ka 3 dhoma për paraburgim dhe 2 dhoma për bisedë.

Dhomat për paraburgimin e personave kanë nga 1 krevat secila, të cilëve u mungonin jastëkët. Dhomat i plotësojnë standardet për madhësinë, gjerësinë dhe gjatësinë, dritën, temperaturën dhe lagështinë. Ambientet e paraburgimit kishin gjithashtu një tualet për të paraburgosurit që i

plotësonte standardet dhe kishte një nivel të kënaqshëm të higjienës. Ekziston mbikëqyrje funksionale me video në dhomat e paraburgimit, por pa sistem thirrjeje.

SP Shtip nuk ka ambiente për bisedë me fëmijë dhe nuk siguron qasje për personat me aftësi të kufizuara fizike në dhomat e paraburgimit. Ai po përballet me një mungesë të automjeteve zyrtare, pra ka vetëm 1 automjet patrullues dhe 1 automjet ndërhyrjeje, i cili është gjysëmfunksional. Përveç mungesës së automjeteve zyrtare, stacioni i policisë po përballet me një mungesë serioze të furnizimeve të pajisjeve dhe inventarit për zyrë (kompjuterë, tonerë, printerë, etj.).

Gjatë vizitës takuam 1 person të paraburgosur, i cili nuk kërkoi avokat.



Ambiente për personat e paraburgosur



Tualeti për personat e paraburgosur

Rekomandime:

- Sigurimi i automjeteve funksionale të shërbimit për ndërhyrje;
- Sigurimi i një sistemi thirrjeje në dhomat e paraburgimit;
- Sigurimi i jastëkëve për shtretër në dhomat e paraburgimit.

SP KISELLA VODË

Më 27.05.2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Kisella Vodë.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në stacionin e policisë u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandantin dhe udhëheqësin e turnit të SP Kisella Vodë.

Gjatë bisedës me punonjësit, morëm informacion se numri i përgjithshëm i punonjësve në stacionin e policisë është 109 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 38 janë gra dhe 10 trajnuese.

Në periudhën nga 26.04.2021 deri më 26.05.2021 në SP Kisella Vodë u privuan nga liria gjithsej 67 persona të moshës 17-64 vjeç. Prej tyre, 38 u mbajtën në paraburgim me një kohëzgjatje mesatare prej 4 orësh. Në 1 rast, u përdor një mjet detyrimi, përkatësisht prangat dhe levë dore shtesë. E drejta për mbrojtje u ushtrua nga 12 persona dhe 3 e ushtruan të drejtën për ndihmë mjekësore, në 1 rast për shkak të lëndimeve të mëparshme, në 1 rast për shkak të sëmundjeve të mëparshme dhe në 1 rast për shkak të çrregullimeve mendore.

Për personat e paraburgosur për më shumë se 6 orë në një stacion të policisë, stacioni ka burime financiare për t'u siguruar atyre një shujtë ushqimi.

Komandantja e stacionit të policisë e informoi ekipin se ata shpesh kanë problem me thirrjen e avokatëve që janë në listën e avokatëve në detyrë, gjë që ka një efekt të dëmshëm në qasjen në drejtësi të personave të privuar nga liria. Nga ana tjetër, ajo theksoi se sa herë që bëhet fjalë për heqjen e lirisë ose bisedën me një fëmijë, bashkëpunimi me QPS-në është i mirë, si dhe bashkëpunimi me Shërbimin e Mjekësisë Emergjente në rast nevojë për ndihmë mjekësore për personat e privuar nga liria.

Kushtet materiale

SP Kisella Vodë ka 6 dhoma për paraburgim, 3 dhoma për kryerjen e një bisede, 1 dhomë për të biseduar me fëmijë dhe 1 dhomë për identifikim.

Dhomat për paraburgimin e personave kanë 2 shtretër, një tavolinë dhe një karrige që janë të fiksuara në dysheme dhe i plotësojnë standardet për nga madhësia, gjerësia dhe gjatësia, lagështia, drita dhe temperatura. Ambientet kanë mbikëqyrje funksionale me video, sistem thirrjeje dhe sistem ngrohjeje.

Stacioni i policisë po përballlet me një mungesë të automjeteve zyrtare. Gjegjësisht, stacioni i policisë ka 6 automjete, nga të cilat vetëm 2 janë në përdorim, por nuk janë për ndërhyrje të shpejtë. Për shkak të frekuencës së lartë, stacioni i policisë shpesh huazon automjete nga stacionet e tjera të policisë.

Personat me aftësi të kufizuara fizike nuk kanë qasje në ambientet për biseda dhe ambientet e paraburgimit.



Ambient për bisedë me të paraburgosurit



Ambient për bisedë me fëmijët



Ambient për personat e paraburgosur



Fletushka me të drejta për personat e privuar nga liria

Rekomandime:

- Sigurimi i automjeteve funksionale të shërbimit për ndërhyrje;
- Sigurimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuara fizike në dhomën e bisedës dhe paraburgimit;
- Vendosja e bashkëpunimit me DhARMV-në në mënyrë që të tejkalohet problemi me avokatët të cilët janë në listën e avokatëve në detyrë, por shpesh janë të paarritshëm për personat e privuar nga liria.

SP STRUMICË

Më 02.06.2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në SP Strumicë.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në stacionin e policisë u krye në mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me udhëheqësin e zonës së sigurisë në SP Strumicë.

Gjatë bisedës me udhëheqësin, ne morëm informacion se numri i përgjithshëm i të punësuarve në stacionin e policisë është 66 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 12 janë gra.

Në periudhën nga 01.05.2021 deri më 01.06.2021 në SP Strumicë u privuan nga liria 8 persona të moshës 21-47 vjeç. 5 prej tyre u mbajtën në paraburgim nga 7 deri në 21 orë. Në 4 raste, u përdor një mjet detyrimi, në 3 raste pranga dhe në një rast një levë dore shtesë. Asnjë person nuk e ka ushtruar të drejtën për avokat ose të drejtën për ndihmë mjekësore.

Për personat që janë paraburgosur për më shumë se 6 orë në stacionin e policisë, komandanti informoi se ata kishin mundësi financiare për t'u siguruar atyre një shujtë ushqimi.


Kushtet materiale

PS Strumicë ka 3 dhoma për paraburgim, kurse stacioni nuk disponon me dhoma të posaçme për të biseduar me njerëzit.

Dhomat për mbajtjen e personave kanë 2 shtretër, një tavolinë dhe një karrige që janë të fiksuara në dysheme dhe i plotësojnë standardet për madhësinë, gjerësinë dhe gjatësinë. Drita artificiale në dhoma ishte mjaft e ulët dhe nuk kishte ngrohje në dhomat. Për më tepër, afishet me të drejtat e personave të paraburgosur ishin ngjitur në ambientet, por një prej ambienteve nuk kishte poster në gjuhën maqedonase. Personat e paraburgosur e përdorin të njëjtin tualet me stafin e stacionit të policisë.

Stacioni i policisë gjithashtu përballet me një mungesë të automjeteve zyrtare, respektivisht ka 6 automjete, nga të cilat vetëm 2 janë plotësisht funksionale, kurse nga automjetet e ndërhyrjes ka vetëm 1 që nuk është në gjendje të mirë.

Stacioni i policisë nuk ka mbikëqyrje funksionale me video në dhomat e bisedës dhe paraburgimit, kurse sistemi i thirrjeve në dhomat e paraburgimit është funksional.



Ambiente për personat e paraburgosur



Afise me të drejtat e personave të paraburgosur

Rekomandime:

- Sigurimi i automjeteve funksionale të shërbimit për ndërhyrje;
- Sigurimi i mbikëqyrjes funksionale me video në dhomat e paraburgimit dhe marrjes në pyetje të personave;
- Sigurimi i dritës së përshtatshme artificiale në vendet e paraburgimit;
- Sigurimi i dhomave të veçanta për të biseduar me njerëzit.
- Rregullimi i një tualeti të veçantë për të paraburgosurit.

SP OHËR

Më 11 qershor 2021, ekipi i monitorimit zhvilloi një vizitë të rregullt në Stacionin e Policisë Ohër.

Të dhëna të përgjithshme

Vizita në stacionin e policisë u krye në atë mënyrë që së pari u zhvillua një bisedë me komandantin dhe udhëheqësin e turnit të stacionit të policisë.

Gjatë bisedës me punonjësit, morëm informacion se numri i përgjithshëm i punonjësve në stacionin e policisë është 66 persona. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, vetëm 8 janë gra.

Në periudhën prej 11.05.2021 deri 10.06.2021, gjithsej 12 persona të moshës 22 deri 61 vjeç ishin privuar nga liria në Stacionin e Policisë Ohër. Nga këta, gjithsej 5 persona ishin mbajtur në paraburgim për një kohëzgjatje mesatare prej 8 orësh. Mjetet shtrënguese u përdorën kundër 2 personave. 5 persona e ushtruan të drejtën e tyre për një avokat dhe 4 persona kërkuan ndihmë mjekësore.

Stacioni i policisë theksoi se ka një bashkëpunim shumë të dobët me QPS-në kompetente - Ohër. Gjegjësisht, shpesh në rastet e privimit të lirisë së një fëmije, punonjësit socialë, megjithëse njoftohen në kohë, nuk vijnë në stacionin e policisë. Kur bëhet fjalë për fëmijët, përveç kësaj, oficerët e policisë informuan se ata kanë vështirësi në bashkëpunimin me avokatët e fëmijëve.

Nga ana tjetër, bashkëpunimi me Shërbimin e Urgjencës Mjekësore është i mirë në rastet kur personat e privuar nga liria dëshirojnë ta ushtrorjnë të drejtën e tyre për ndihmë mjekësore.

Për personat që janë të paraburgosur për më shumë se 6 orë në një stacion të policisë, stacioni nuk ka mundësi financiare për të siguruar ushqim për të

arrestuarit, kështu që oficerët e policisë ndonjëherë sigurojnë një shujtë me shpenzimet e tyre.

Kushtet materiale

SP Ohër ka 2 dhoma për paraburgim dhe si dhoma për biseda përdoren dhomat/zyrat administrative të zyrtarëve.

Dhomat për paraburgimin e personave kanë 1 krevat, një tavolinë dhe një karrige që janë të fiksuara në dysheme. Dhomat i plotësojnë standardet për nga madhësia, gjerësia dhe gjatësia, si dhe lagështia, por jo për dritën, e cila ishte shumë e dobët, pa e përmbushur nivelin e vëllimit në të cilin një person mund të lexonte një libër. Gjatë muajve të dimrit, ambientet nuk ngrohen, prandaj oficerët e policisë rregullojnë ambiente të tjera për të paraburgosur persona të privuar nga liria. Në ambientet e paraburgimit nuk kishte tualete për të paraburgosurit. Ekziston një mbikëqyrje funksionale me video në dhomat e paraburgimit, si dhe një sistem thirrjesh (zile).

Zyrtarët nga Stacioni i Policisë Ohër na informuan se ata gjithashtu përballen me vështirësi në punë sepse nuk ka ambiente paraburgimi në Stacionin e Policisë Strugë, kështu që të gjithë personat nga atje dërgohen në Stacionin e Policisë Ohër.

Stacioni i policisë nuk ka një dhomë për të biseduar me një fëmijë dhe nuk siguron qasje për personat me aftësi të kufizuara fizike në mjediset e paraburgimit.

Stacioni i policisë po përballlet me një mungesë të automjeteve zyrtare, respektivisht ka vetëm 2 automjete ndërhyrjeje, nga të cilat 1 shpesh servisohet dhe me 3-4 të tjera kryhet patrullimi.

Gjatë kohës së zhvillimit të vizitës nuk takuam asnjë të paraburgosur.



Detention room and leaflet with the rights of the detainees

Recommendations:

- Providing functional official vehicles for intervention;
- Providing an adequate level of light in the detention rooms;
- Establishment of cooperation with the SWC – Ohrid as well as with AKRSM in order to have unhindered access to justice and protection of children's rights;
- To solve the problem with the heating in the detention rooms;
- Providing financial means for a meal to persons detained for more than 6 hours;
- Providing access for persons with physical disabilities to detention facilities.

Qasja për një avokat në stacionet e policisë si një mjet për t'i parandaluar torturat dhe trajtimin çnjerëzor

Shumë standarde ndërkombëtare dhe rajonale i referohen të drejtës për avokat si një nga garancitë kryesore procedurale për mbrojtjen e personave të privuar nga liria nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor. Avokati është një garanci që personi të informohet, edhe për të drejtat e tjera që i gëzon gjatë kohës së privimit nga liria (e drejta për të informuar një palë të tretë, e drejta për një mjek, etj.), dhe në të njëjtën kohë i mbron personat nga privimi i paligjshëm nga liria dhe nga burgosja e personave në kushte johumane.

Për këtë qëllim, personave të privuar nga liria duhet t'u mundësohet që të kontaktojnë një avokat sa më shpejt të jetë e mundur pas privimit të tyre nga liria. Sigurimi i qasjes efektive në një avokat e zvogëlon rrezikun e trajtimit arbitrar të oficerëve të policisë ndaj personave të privuar nga liria.

Sipas të dhënave të marra nga ekipi i monitorimit në lidhje me qasjen e personave në një avokat gjatë privimit të tyre nga liria, ne morëm informacion se jo të gjithë personat e paraburgosur e ushtrojnë këtë të drejtë.

Sipas të dhënave të marra, 313 persona janë paraburgosur në gjithsej 9 stacione të policisë në periudhën prej një muaji para vizitës së kryer. Vetëm 36 prej tyre e kanë ushtruar të drejtën për avokat. Sipas të dhënave, nga numri i përgjithshëm i personave të paraburgosur, vetëm 13% e tyre e kanë ushtruar të drejtën për avokat.

Problemi me qasjen në avokat në praktikë përmendet gjithashtu edhe nga ana e oficerëve të policisë gjatë vizitave monitoruese. Ata deklaruan se vetë personat e paraburgosur nuk ishin të interesuar të thërrisnin një avokat, kryesisht për shkak të implikimeve financiare dhe kostove që duhej t'i mbulonin vetë. Madje edhe kur vendosin të angazhojnë një avokat me shpenzimet e tyre dhe të kërkojnë një listë të avokatëve në detyrë, shumë nga avokatët e thirrur refuzojnë të paraqiten në stacionin e policisë.

Mungesa e avokatëve shpesh tregon se ndihma juridike që u jepet personave në këtë fazë nuk është “aq e rëndësishme” ose është e vështirë të merret kompensimi financiar nga individët.

Megjithatë, ka një mungesë të dhënash se sa prej të paraburgosurve e kanë shfrytëzuar mundësinë për të angazhuar një avokat gjatë natës në kurriz të buxhetit të shtetit të lejuar nga ligji dhe sa e realizueshme është në praktikë kjo.² Duke marrë në konsideratë se praktika na tregon se kur shpenzimet për avokatin paguhet nga buxheti i shtetit, është me një vonesë prej një viti dhe më shumë. Supozimi është se për shkak të kësaj avokatët nuk janë të interesuar të përfshihen në këtë fazë të procedurës penale.

Mendimi i përgjithshëm është se të paraburgosurit kanë nevojë për një avokat më shumë në procedurat gjyqësore, por është e padiskutueshme që e drejta për një avokat luan një rol të madh në drejtim të parandalimit të torturës dhe është një garanci themelore për parandalimin e keqtrajtimit të të paraburgosurve dhe nga kjo pikëpamje duhet të bëhen ndryshime sistematike në mënyrë që ato të zbatohen në mënyrë efektive edhe në praktikë.

KPT-ja gjithashtu thekson se ka probleme në ushtrimin e së drejtës për avokat në raportin e tij të fundit, i cili thotë se një numër i madh i personave të privuar nga liria deklaruan se nuk kishin mundësi të konsultoheshin me një avokat deri në seancën gjyqësore. Nga ana tjetër, gjatë inspektimit të regjistrave në një numër të stacioneve të policisë, u vërejt se një numër i madh i personave kishin deklaruar se nuk kishin nevojë për një avokat.³

Lidhur me mbrojtjen e të varfërve, edhe legjislacioni kombëtar kur bëhet fjalë për angazhimin e një avokati në kurriz të buxhetit të shtetit për të paraburgosurit, e lejon atë vetëm nëse paraburgimi është natën. Ligji e parashikon gjithashtu mundësinë e emërimit të një avokati në buxhetin e

²Ligji për Procedurën Penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 150/2010, 198/2018 (neni 161)

³Raporti i KPT-së nga vizita e pestë në RMV e kryer nga O2 deri më 10 dhjetor 2019
<https://rm.coe.int/1680a26b8f>

shtetit, nëse sipas situatës pasurore i pandehuri nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes, të cilat kërkohen nga interesat e drejtësisë dhe veçanërisht nga rëndësia e krimit dhe kompleksiteti i çështjes⁴. Ekziston një mungesë e dispozitave të qarta nëse kjo vlen edhe për të paraburgosurit, si dhe dispozita të qarta për përcaktimin dhe vërtetimin e gjendjes financiare të personit.

Edhe e drejta ndërkombëtare sugjeron gjithashtu që kur një i paraburgosur nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar një avokat, ai ose ajo duhet t'i marrë ato falas nga shteti. Prandaj, shteti duhet të bëjë përpjekje për të krijuar një sistem funksional të ndihmës juridike falas në të cilin Oda e Avokatëve, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme do të bashkëpunojnë në mënyrë aktive. Sistemi i ndihmës juridike falas duhet të sigurojë akses për personat e privuar nga liria, veçanërisht për grupet më të marginalizuara, në ndihmë juridike cilësore dhe në kohë e cila do të jetë gjithashtu një mjet për parandalimin e torturave dhe trajtimit çnjerëzor.

⁴ Ligji për Procedurën Penale, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 150/2010, 198/2018 (neni 75)

PASQYRË TABELARE E SITUATËS NË STACIONET E VIZITUARA TË POLICISË

	KUADRI (STAFI)		TË DREJTAT		KUSHTET E PËRGJITHSHME									
	Sistematizimi	Gra	Afise të vendosura me të drejtat e personave të privuar nga liria	Të privuar nga liria një muaj para vizitës	Të paraburgosur	Kohëzgjatja e paraburgimit	Fonde për shujtat e personave të paraburgosur	Persona ndaj të cilëve janë zbatuar mjemet e detyrimit	Kanë kërkuar avokat	Bashkëpunimi me avokatët	Bashkëpunimi me QPS-në	E drejta për ndihmë mjekësore	Akuza për sjellje të paligjshme të një oficeri të policisë	
SP Qendër	50%	20	PO	31	13	105 min.-21 orë	PO	2	9	i keq	/	/		
SP Manastir	79 nga 130	10	PO	21	4	5-9 orë	JO	4	/	i keq	2	/		
SP Veles	85	11	PO	41	18	8-14 orë	JO	1	5	i mirë	1	/		
SP Kumanovë	141	21	PO	31	31	35 min.-23 orë e 15 min.	PO	1	/	/	/	/		
SP Tetovë	109	7	PO	88	65	1-18 orë	/	6	4	/	/	/		
SP Shtip	69	7	PO	14	8	50 min.-11 orë e 30 min.	PO	4	1	/	/	/		
SP Kisella Vodë	109	38	PO	67	38	4 orë	PO	1	12	i keq	3	/		
SP Strumicë	66	12	JO	8	5	7-21 orë	PO	4	/	/	/	/		
SP Ohër	66	8	PO	12	5	8 orë	JO	2	5	/	4	/		

* //"-nuk ka kërkuar askush ose nuk ka të dhëna

KUSHTET MATERIALE												
	Automjete/makina	2										
	Sistemi audio dhe video	FUNKSIONAL										
	Sistem audio dhe video	PO										
	Qasja për personat me aftësi të kufizuara fizike	JO										
	Hapësirë për biseda me fëmijë	NUK KA	1	PO								
	Sistem thirrjeje (zile)	PO										
	Higjiena në tualet	E MIRË		E KEQE PA DERË								
	Tualet	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
	Higjiena në hapësirat e parburgimit	E MIRË		SHTROJE E PAPANASTËR								
	Ngrohje	PO		JO								
	Kushtet sipas KPT-së	PO		JO								
	Hapësira (dhoma) për paraburgim	1		3								
	Higjiena në dhomën e bisedave	PASTËR		/								
	Zyra për biseda	1		/								
	Zyra administrative	2		12								
SP Qendër												
SP Manastir												
SP Veles												
SP Kumanovë												
SP Tetovë												
SP Shtëp												
SP Kisella Vodë												
SP Strumicë												
SP Ohër												

*,,/” - nuk ka të dhëna

**RAPORT PËR SITUATËN DHE KUSHTET NË STACIONET E POLICISË NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT
MARS – QËRSHOR 2021**